LIGJ
Nr. 13/2019

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE PËR SHKËMBIMIN E AUTOMATIZUAR TË TË DHËNAVE TË ADN-SË, DAKTILOSKOPIKE DHE TË TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE DHE MARRËVESHJES SË SAJ ZBATUESE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më 5.3.2019

Shpallur me dekretin nr. 11143, datë 11.3.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET PALËVE TË KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE PËR SHKËMBIMIN E AUTOMATIZUAR TË TË DHËNAVE TË ADN-SË, DAKTILOSKOPIKE DHE TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE

Palët në këtë Marrëveshje,

Bazuar në Konventën e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (në vijim referuar si PCC SEE),

Me dëshirën për të forcuar bashkëpunimin ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm, duke u përpjekur për zbatimin e PCC SEE, veçanërisht në transmetimin dhe krahasimin e profileve të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve,

Duke pasur parasysh përfundimet e Komitetit të 11-të Ministrave të PCC SEE (01/2014), përfundimet e Komitetit të 12-të Ministrave të PCC SEE (05/2014) dhe përfundimet e Komitetit të 15-të Ministrave të PCC SEE (01/2016), që theksojnë nevojën e fuqishme për zhvillimin e të dhënave të automatizuara të ADN-së, e të dhënave daktiloskopike dhe shkëmbimin e informacionit të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, brenda kuadrit ligjor të PCC SEE,

Duke pranuar zhvillimet e PCC SEE në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave, ku të gjitha palët kanë kaluar me sukses vlerësimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe, për rrjedhojë, kanë plotësuar parakushtet për shkëmbimin e të dhënave personale, duke marrë në konsideratë parimet dhe standardet e përgjithshme evropiane të mbrojtjes së të dhënave siç mishërohen në Direktivën (BE), 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 27 prillit 2017 mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente, me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/877/JHA (më poshtë referuar si: "Direktiva (BE) 2016/680") dhe konventën përkatëse të Këshillit të Europës mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe rekomandimin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale për sektorin policor (më poshtë referuar si "Konventa përkatëse e Këshillit të Europës dhe Rekomandimet"),

Duke pasur parasysh dispozitat që rrjedhin nga Traktati i 27 majit 2005 ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës, Republikës Federale të Gjermanisë, Mbretërisë së Spanjës, Republikës Franceze, Dukatit të Madh të Luksemburgut, Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Austrisë në nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migrimit të paligjshëm (në vijim i referuar si "Traktati Prüm"), Marrëveshja Zbatuese e Traktatit Prüm, vendimi i Këshillit 2008/615/JHA i 23 qershorit 2008 për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkufitar (në vijim i referuar si: Vendimi Prüm") dhe vendimin e Këshillit 2008/616/JHA të 23 qershorit 2008 për zbatimin e vendimit 2008/615/JHA në nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkufitar (në vijim i referuar si Vendimi i Zbatimit të Prüm-it),

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi, synimi dhe përkufizimet

1. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, palët synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar policor, duke luftuar kërcënimet ndaj sigurisë publike, nëpërmjet parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale, siç përcaktohet në PCC SEE. Për këtë qëllim, kjo Marrëveshje përmban rregullat për shkëmbimin e

automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike, të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe shkëmbimin e të dhënave personale dhe të dhënave në lidhje me çështjen, për rastet kur ato përputhen.

2. Për mbështetjen e zbatimit të transmetimit dhe krahasimit të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve, palët përcaktojnë:

a) dispozitat mbi kushtet dhe procedurat për transferimin e automatizuar të profileve të ADN-së, të të dhënave daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve;

b) dispozitat e nevojshme administrative dhe teknike për zbatimin e shkëmbimit të automatizuar të të dhënave të ADN-së, të të dhënave daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve.

3. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "kërkim" dhe "krahasim" do të thotë procedurat me të cilat përcaktohet nëse ka një ngjashmëri, përkatësisht ndërmjet të dhënave të ADN-së ose të dhënave daktiloskopike, të cilat janë komunikuar nga një palë dhe të dhënave të ADN-së ose të dhënave daktiloskopike të ruajtura në bazat e të dhënave të një, disa, ose të gjitha palëve;

b) "kërkim i automatizuar" do të thotë përdorimi i një procedure *online* për të konsultuar të dhënat e një, disa, ose të gjitha palëve;

c) "profil i ADN-së" do të thotë një kod numerik ose me shkronja, i cili përfaqëson një grup të karakteristikave të identifikimit të pjesës jo-të koduar të një mostre të analizuar të ADN-së njerëzore, domethënë struktura molekulare e veçantë në vende të ndryshme të ADN-së (loci);

d) "pjesë jo e koduar e ADN-së" do të thotë një pjesë kromozomike, e cila nuk shprehet gjenetikisht, për të cilën nuk ka të dhëna se siguron ndonjë veti funksionale të organizmit;

e) "të dhëna të ADN-së" do të thotë profil i ADN-së, numri i referencës dhe të dhënat personale të identifikimit;

f) "të dhëna referuese të ADN-së" do të thotë profil i ADN-së dhe numri i referencës;

g) "referencë e profilit të ADN-së" do të thotë profil i ADN-së të një personi të identifikuar;

h) "profili i paidentifikuar i ADN-së" do të thotë profili i ADN-së i përftuar nga gjurmët e mbledhura gjatë hetimit të veprës kriminale, të cilat i përkasin një personi të paidentifikuar ende;

i) "shënim" do të thotë shenja e një pale në profilin e një ADN-je, në bazën e saj kombëtare të të dhënave që tregon se ka pasur tashmë një ngjashmëri për këtë profil ADN-je në kërkimin apo krahasimin e një pale tjetër;

j) "të dhëna daktiloskopike" do të thotë imazhe të gjurmëve të gishtave, imazhet e latentëve të gjurmëve të gishtave, gjurmët e pëllëmbëve të duarve, latentët e gjurmëve të pëllëmbëve të duarve dhe modelet e imazheve të tilla (*coded minutiae*), kur janë të ruajtura dhe të trajtuara brenda një baze të të dhënave të një sistemi të automatizuar të identifikimit të gjurmëve të gishtave (AFIS);

k) "të dhëna të regjistrimit të automjeteve" do të thotë të dhënat e përcaktuara në nenin 9;

l) "të dhëna personale" do të thotë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm ("subjekti i të dhënave");

m) "të dhëna kryesore personale" do të thotë *Emri (Mbiemri, Emri), Ditëlindja, Shtetësia, Gjinia, Emra* dhe *Ditëlindje* të tjera, data e marrjes së gjurmëve të gishtave / kampionit të ADN-së, arsyen e marrjes së shenjave të gishtave/kampionit të ADN-së, vendin e marrjes së shenjave të gishtave/kampionit të ADN-së, dhe nëse është i disponueshëm, *Statusin e Konfirmimit të Identitetit të Vërtetë, Adresën, Gjatësinë, Peshën, Numrin e Pasaportës, Fotografinë (e fytyrës);*

n) "rast individual" do të thotë një hetim i vetëm apo dosje në ndjekje; nëse një dosje e tillë përmban më shumë se një profil ADN-je, ose një pjesë të të dhënave daktiloskopike që mund të transmetohen së bashku si një kërkesë e vetme;

o) "përpunim i të dhënave personale" do të thotë çdo veprim ose numër veprimesh që kryhen në të dhënat personale, në mënyrë automatike ose jo, të tilla si grumbullimi, regjistrimi, organizimi, ruajtja,

përshtatja ose ndryshimi, klasifikimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi me furnizimin, shpërndarja ose ndryshe vënia në dispozicion, shtrirja, kombinimi, fshirja ose shkatërrimi i të dhënave; përpunimi, në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje, do të përfshijë gjithashtu njoftimin nëse ekziston apo jo një përputhje;

p) "procedurë e kërkimit të automatizuar" nënkupton akses në rrjet në bazat e të dhënave të një pale tjetër, ku përgjigja për procedurën e kërkimit është plotësisht e automatizuar;

q) "persona të humbur" do të thotë persona mungesa e të cilëve prezumohet në lidhje me një krim, vetëvrasje, aksident apo fatkeqësi;

r) "ngjashmëri / mosngjashmëri" do të thotë rezultati i një makinerie (AFIS ose motor kërkimi ADN). Do të thotë gjithashtu që një mosngjashmëri është gjithmonë një mospërputhje. Nga ana tjetër, është gjithashtu e mundur që një ngjashmëri të jetë një mospërputhje pas verifikimit /vlerësimit të nevojshëm të policisë shkencore;

s) "përputhje" do të thotë një rezultat identifikimi pozitiv i konfirmuar nga një njeri (ekspert) pas verifikimit / vlerësimit të policisë shkencore. Konfirmimi i policisë shkencore duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e menaxhimit të cilësisë të policisë shkencore (p.sh., i standardeve të akreditimit);

t) "dosjet e analizës së ADN-së" do të thotë bazat e të dhënave kombëtare të ADN-së, dhe nënsistemet administrative të lidhura, si p.sh., njollat në skenat e krimit / bazat e të dhënave të identifikimit të personave dhe sistemet e informacionit të laboratorëve (LIMs), që përmbajnë gjithë informacionin që lidhet me policinë shkencore dhe konfirmimin e profileve të analizuara të ADN-së në hetim, me teknologji ADN-je dhe që do të lejojnë lidhje të sigurt me çështje individuale / të dhëna personale të profileve të ADN-së.

u) "vepra penale" do të thotë ato shkelje të cilat ndiqen penalisht *ex officio* (kryesisht) në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve.

KAPITULLI II
AKSESI *ONLINE* DHE KËRKESAT NË VIJIM

Neni 2
Krijimi i dosjeve të analizës së ADN-së kombëtare

1. Palët do të hapin dhe do të mbajnë dosjet e analizës së ADN-së kombëtare për hetimin e veprave penale dhe për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe mbetjeve njerëzore të paidentifikuara në përputhje me legjislacionin kombëtar. Përpunimi i të dhënave të mbajtura në këto dosje, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të kryhet në përputhje me këtë Marrëveshje, në përputhje me PCC SEE dhe legjislacionin kombëtar të zbatueshëm për përpunimin e të dhënave.

2. Për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do të sigurojnë disponueshmërinë e të dhënave referuese nga dosjet e tyre të analizave të ADN-së kombëtare, siç thuhet në fjalinë e parë të paragrafit 1. Të dhënat referuese do të përfshijnë vetëm profilet e ADN-së të krijuara nga pjesa jo e koduar e ADN-së dhe një numër reference. Të dhënat e referencës nuk duhet të përmbajnë asnjë të dhënë nga të cilat subjekti i të dhënave mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Të dhënat referuese që nuk i atribuohen ndonjë individi (profile të ADN-së të paidentifikuar) duhet të jenë të njohura si të tilla.

3. Çdo palë do të njoftojë Depozitarin mbi dosjet kombëtare të analizave të ADN-së, për të cilat zbatohen nenet 2 deri në 4 dhe neni 7 dhe kushtet për kërkimin e automatizuar, siç përmendet në nenin 3 pika 1.

Neni 3
Kërkimi automatik i profileve të ADN-së

1. Për hetimin e veprave penale për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe të mbetjeve njerëzore të paidentifikuara, palët do të lejojnë pikat kombëtare të kontaktit të palëve të

tjera, siç referohet në nenin 8, të kenë akses në të dhënat referuese në dosjet e tyre analizës së ADN-së, me kompetencën për të kryer kërkimet e automatizuara, duke krahasuar profilet e ADN-së. Kërkimet mund të kryhen vetëm në raste individuale dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës kërkuese.

2. Nëse një kërkim i automatizuar tregon se profilet e ADN-së ofruese ngjajnë me profilet e ADN-së të përfshira në dosjet e kërkimit të palës pritëse, pika kombëtare e kontaktit e palës kërkuese do të marrë në mënyrë të automatizuar të dhënat referuese me të cilat është konstatuar ngjashmëria. Nëse nuk konstatohet ngjashmëri, do të jepet një njoftim i automatizuar.

Neni 4

Krahasimi i automatizuar i profileve të ADN-së

1. Për hetimin e veprave penale dhe për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe mbetjeve njerëzore të paidentifikuara, palët, me pëlqim të përbashkët, nëpërmjet pikave të tyre kombëtare të kontaktit, do të krahasojnë profilet e ADN-së, të profileve të tyre të paidentifikuara të ADN-së, me të gjitha profilet e ADN-së nga të dhënat e referencës të dosjeve të analizës së ADN-së kombëtare. Profilet do të ofrohen dhe krahasohen në një formë të automatizuar. Profilet e paidentifikuara të ADN-së do të ofrohen për krahasim vetëm në raste kur parashikohet në legjislacionin kombëtar të palës kërkuese.

2. Nëse një palë, sipas rezultatit të krahasimit të referuar në paragrafin 1, konstaton se ndonjë profil ADN-je i ofruar ngjan me ato në dosjet e analizës së ADN-së, ajo do t'i ofrojë pa vonesë pikës kombëtare të kontaktit të palës tjetër të dhënat e referencës të ADN-së me të cilat është konstatuar një ngjashmëri.

Neni 5

Të dhënat daktiloskopike

Për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do të sigurojnë disponueshmërinë e të dhënave referuese nga dosja për sistemet kombëtare të automatizuara të identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve të krijuara për parandalimin dhe hetimin e veprave penale dhe për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe të mbetjeve njerëzore të paidentifikuara. Të dhënat referuese do të përfshijnë vetëm të dhënat daktiloskopike dhe një numër reference. Të dhënat referuese nuk duhet të përmbajnë asnjë të dhënë nga të cilat subjekti i të dhënave mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Të dhënat referuese të cilat nuk i atribuohen ndonjë individi (të dhënat daktiloskopike të paidentifikuara) duhet të jenë të njohura si të tilla.

Neni 6

Kërkimi i automatizuar i të dhënave daktiloskopike

1. Për parandalimin dhe hetimin e veprave penale për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe të mbetjeve të paidentifikuara njerëzore, palët do të lejojnë pikat kombëtare të kontaktit të palëve të tjera siç referohet në nenin 8, akses në të dhënat referuese në sistemet e automatizuara të identifikimit të gjurmëve të gishtave, të cilin e kanë krijuar për këtë qëllim me të drejtën për të kryer kërkime të automatizuara duke krahasuar të dhënat daktiloskopike. Kërkimet do të kryhen vetëm në raste individuale dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës kërkuese.

2. Konfirmimi i ngjashmërisë së të dhënave daktiloskopike me të dhënat referuese që mbahen nga pala që administron dosjen, do të kryhet nga pika kombëtare e kontaktit të palës kërkuese me anë të ofrimit të automatizuar të të dhënave referuese të nevojshme për një përputhje.

Neni 7

Ofrimi i të dhënave personale të mëtejshme dhe informacioneve të tjera

Nëse procedurat e referuara në nenin 3 dhe 4 tregojnë një përputhje midis profileve të ADN-së apo procedurave të referuara në nenin 6 tregojnë një përputhje ndërmjet të dhënave daktiloskopike, ofrimi i të dhënave të tjera personale përveç të dhënave kryesore personale dhe informacione të tjera që lidhen me të dhënat referuese, duke përfshirë rregullat e ndihmës ligjore, do të kryhet në bazë të legjislacionit kombëtar të palës kërkuese. Subjekt i nenit 8, paragrafi 2, ofrimi do të bëhet nga një pikë kombëtare kontakti.

Neni 8

Pikat kombëtare të kontaktit

1. Për qëllimet e ofrimit të të dhënave, siç referohet në nenet 3, 4 dhe 6, si dhe për ofrimin e të dhënave personale të tjera dhe informacioneve të tjera të lidhura me të dhënat e referencës, siç referohet në nenin 7, çdo palë do të caktojë një pikë kombëtare kontakti. Do të caktojë pikën kombëtare të kontaktit, të përmendur në nenet 3 dhe 4 për të dhënat e ADN-së, pikën kombëtare të kontaktit, të përmendur në nenin 6 për të dhënat daktiloskopike, pikën kombëtare të kontaktit, të përmendur në nenin 9 për të dhënat e regjistrimit të automjeteve dhe pikën kombëtare të kontaktit të përmendur në nenin 7 për të dhënat personale.

2. Pika kombëtare e kontaktit siç referohet në nenin 7 do të ofrojë në vijim të dhëna të tilla personale në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës që përcakton pikën kombëtare të kontaktit përgjegjëse. Kanalet e tjera të ndihmës ligjore në dispozicion nuk do të përdoren, përveç rasteve kur është e nevojshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke përfshirë rregullat e ndihmës ligjore të palëve.

Neni 9

Kërkimi i automatizuar i të dhënave të regjistrimit të automjeteve

1. Për parandalimin dhe hetimin e veprave penale dhe për të ndihmuar në identifikimin e personave të humbur dhe të mbetjeve të paidentifikuara njerëzore dhe në lidhje me vepra të tjera penale, në kuadër të juridiksionit të gjykatave apo të shërbimit të prokurorisë publike në palën Kërkuese, si dhe në ruajtjen e sigurisë publike, palët do t'i lejojnë pikave kombëtare të kontaktit të palëve të tjera, akses në të dhënat e mëposhtme të regjistrimit kombëtar të të dhënave të automjeteve, me të drejtën për të kryer kërkime të automatizuara në raste individuale:

a) të dhënat e lidhura me pronarët apo drejtuesit; dhe

b) të dhënat e lidhura me automjetet.

Kërkimet mund të bëhen vetëm më një numër të plotë të shasisë apo me një numër të plotë të regjistrimit. Kërkimet mund të kryhen vetëm dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës kërkuese.

2. Për qëllimet e ofrimit të të dhënave siç referohet në paragrafin 1, çdo palë do të përcaktojë një pikë kombëtare kontakti për kërkesat hyrëse. Kompetencat e pikave kombëtare të kontaktit do të drejtohen nga legjislacioni kombëtar i zbatueshëm. Detajet e rregullimeve teknike për procedurat do të përcaktohen në Manualin e Përdorimit për Regjistrimin e të Dhënave të Automjeteve.

KAPITULLI III

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA NË KUADËR TË SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE

Neni 10

Parimet e shkëmbimit të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike

1. Palët do të përdorin standardet ekzistuese për shkëmbimin e të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike.

2. Procedura e transmetimit, në rast të kërkimit të automatizuar dhe krahasimit të profileve të ADN-së dhe të të dhënave daktiloskopike, do të realizohen brenda një strukture të decentralizuar.

3. Do të merren masat e duhura për të siguruar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave që u dërgohen palëve të tjera, duke përfshirë kriptimin e tyre.

4. Palët do të marrin masat e nevojshme për të garantuar integritetin e profileve të ADN-së dhe të dhënave daktiloskopike të vëna në dispozicion ose të dërguara për krahasim drejt palëve të tjera dhe për të siguruar që këto masa të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 11

Specifikimet procedurale dhe teknike

1. Palët do të mbikëqyrin specifikimet e përbashkëta teknike në përputhje më të gjitha kërkesat dhe përgjigjet që lidhen me kërkimet dhe krahasimet e profileve të ADN-së, daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve.

2. Këto specifikime teknike dhe procedurale janë përcaktuar në Marrëveshjen Zbatuese dhe Manualet e Përdorimit.

KAPITULLI IV
MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 12

Niveli i mbrojtjes së të dhënave

Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të cilat janë ose kanë qenë ofruar në bazë të kësaj Marrëveshjeje, çdo palë do të garantojë një nivel të mbrojtjes së të dhënave personale në legjislacionin e saj kombëtar thelbësisht të barasvlershëm me parimet dhe standardet e mishëruara në Direktivën (BE) 2016/680 dhe Konventës përkatëse të Këshillit të Europës dhe rekomandimeve.

Neni 13

Qëllimi

1. Përpunimi i të dhënave personale nga pala pritëse do të lejohet vetëm për qëllimet për të cilat të dhënat janë ofruar në përputhje me këtë Marrëveshje. Përpunimi për qëllime të tjera do të lejohet vetëm me autorizim paraprak të palës që administron dosjen dhe do të jetë subjekt i legjislacionit kombëtar të palës pritëse. Ky autorizim mund të jepet me kusht që përpunimi për këto qëllime të tjera të jetë i lejuar në bazë të legjislacionit kombëtar të palës që administron dosjen.

2. Përpunimi i të dhënave të ofruara në përputhje me nenet 3, 4 dhe 6 nga pala kërkuese apo krahasuese, do të lejohet vetëm me qëllim që:

a) të përcaktohet nëse ka ngjashmëri mes profileve të ADN-së të krahasuara;

b) të përcaktohet nëse ka ngjashmëri mes të dhënave daktiloskopike të krahasuara;

c) të përgatisë dhe të paraqesë një kërkesë policore ose gjyqësore për ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin kombëtar, nëse ka përputhje mes këtyre të dhënave nëpërmjet pikës kombëtare të kontaktit, të caktuar në përputhje me nenin 7 dhe 8;

d) Të regjistrohet sipas kuptimit të nenit 17.

3. Pala që administron dosjen mund të përpunojë të dhënat e ofruara në përputhje me nenet 3, 4 dhe 6, vetëm kur kjo është e nevojshme për qëllime të krahasimit, duke siguruar përgjigje të automatizuara për kërkimet ose regjistrimin, në bazë të nenit 17. Të dhënat e ofruara duhet të fshihen menjëherë pas krahasimit të të dhënave ose përgjigjeve të automatizuara të kërkimeve, nëse përpunimi i mëtejshëm nuk është i nevojshëm për qëllimet e përmendura në pikat b) dhe c) të paragrafit të dytë.

4. Të dhënat e ofruara në përputhje me nenin 9 mund të përdoren nga palët për administrimin e dosjes vetëm kur kjo është e nevojshme me qëllim të sigurimit të përgjigjeve të automatizuara për

procedurat e kërkimit apo regjistrimit siç përcaktohet në nenin 17. Të dhënat e ofruara do të fshihen menjëherë pas përgjigjeve së automatizuara për kërkim, përveç rasteve kur përpunimi i mëtejshëm është i nevojshëm për regjistrime në përputhje me nenin 17. Pala kërkuese mund të përdorë të dhënat e marra në një përgjigje, vetëm për procedurën për të cilën kërkimi është bërë.

Neni 14

Autoritetet përgjegjëse

Të dhënat personale mund të përpunohen vetëm nga autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit, me përgjegjësinë për një detyrë në mbështetje të qëllimeve të përmendura në nenin 13. Veçanërisht, të dhënat mund t'i ofrohen subjekteve të tjera, vetëm me një autorizim paraprak të palës ofruese dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës pritëse.

Neni 15

Saktësia, lidhja me çështjen dhe koha ruajtjes së të dhënave

1. Palët do të sigurojnë saktësinë dhe lidhjen me çështjen të të dhënave personale. Nëse do të shpërndahen *ex officio (kryesisht)* apo nga një njoftim nga vetë subjekti i të dhënave, të dhëna të pasakta, ose të dhëna të cilat nuk duheshin ofruar, por janë ofruar, kjo do të njoftohet pa vonesë te pala apo palët pritëse. Pala apo palët në fjalë janë të detyruara të korrigjojnë apo të fshijnë të dhënat. Gjithashtu, të dhënat personale e ofruara do të korrigjohen, nëse janë konstatuar se janë të pasakta. Nëse organi pritës ka arsye të besojë se të dhënat e ofruara janë të pasakta apo duhet të fshihen, organi ofrues do të informohet menjëherë.

2. Të dhënat, saktësinë e cilave subjekti i të dhënave konteston, dhe saktësia apo pasaktësia e të cilave nuk mund të përcaktohen, do të, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve, të shënohet me një flamur me kërkesë të subjektit të të dhënave. Nëse ekziston një flamur, kjo mund të hiqet dhe t'i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të palëve dhe vetëm me lejen e subjektit të të dhënave, ose në bazë të një vendimi të gjykatës kompetente apo autoritetit të pavarur për mbrojtjen e të dhënave.

3. Të dhënat personale të ofruara, të cilat nuk duhet të ishin ofruar apo marrë, do të fshihen. Të dhënat të cilat janë ofruar dhe janë marrë në mënyrë të ligjshme do të fshihen:

a) nëse nuk janë apo nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë ofruar; nëse të dhënat personale janë ofruar pa kërkesë, organi pritës do të kontrollojë menjëherë nëse është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë ofruar;

b) pas kalimit të afatit maksimal për mbajtjen e të dhënave të përcaktuar në legjislacionin kombëtar të palës ofruese, kur organi ofrues ka informuar organin pritës për periudhën maksimale në kohën e ofrimit të të dhënave.

Në rastet kur ka arsye të mendohet se fshirja do të cenojë interesat e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të mbahen në vend që të fshihen, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 16

Masat teknike dhe organizative për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave

1. Organet ofruese dhe pritëse do të marrin hapat e mëtejshme për të siguruar që të dhënat personale do të mbrohen kundër shkatërrimit aksidental apo të paautorizuar, humbjes aksidentale, aksesit të paautorizuar, ndryshimit aksidental dhe zbulimit të paautorizuar.

2. Karakteristikat e specifikimit teknik të procedurës së kërkimit të automatizuar janë të rregulluara në masat zbatuese, siç përmendet në nenin 20, i cili garanton se:

a) është ndërmarrë niveli më i lartë i masave teknike për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e të

dhënave, veçanërisht për sa i përket konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave;

b) janë përdorur procedurat e kriptimit dhe autorizimit të njohura nga autoritetet kompetente kur u është drejtuar në rrjetet e dedikuara; dhe

c) pranueshmëria e kërkimeve në përputhje me nenin 17 pika 2, 4 dhe 5 mund të kontrollohet.

Neni 17

Katalogimi dhe regjistrimi: rregulla të veçanta që drejtojnë ofrimin e automatizuar dhe të paautomatizuar

1. Çdo palë do të garantojë se çdo ofrim i paautomatizuar dhe çdo marrje e paautomatizuar e të dhënave personale nga organi që administron dosjen dhe nga organi kërkues, regjistrohet në mënyrë që të verifikohet pranueshmëria e ofrimit. Regjistrimi do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) arsyen e ofrimit;

b) të dhënat e ofruara;

c) datën e ofrimit; dhe

d) emrin e kodit referues të organit kërkues dhe organit që administron dosjen.

2. Sa vijon do të zbatohet për kërkimet automatizuara për të dhënat në bazë të nenit 3, 4 dhe 6 dhe nenit 9:

a) vetëm zyrtarët specifikisht të autorizuar mund të kryejnë kërkime apo krahasime të automatizuara. Lista e zyrtarëve të autorizuar për të kryer kërkime të automatizuara apo krahasime do t'i mundësohet sipas kërkesës dhe autoriteteve mbikëqyrëse të palëve të tjera, referuar në paragrafin 5;

b) çdo palë do të sigurojë se çdo ofrim apo marrje e të dhënave personale nga organi që administron dosjen, është regjistruar nga organi kërkues, duke përfshirë njoftimin nëse ekziston apo jo një ngjashmëri. Regjistrimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

i) të dhënat e ofruara;

ii) datën dhe kohën e saktë të ofrimit; dhe

iii) emrin ose kodin referues të organit kërkues dhe të organit që administron dosjen.

Organi kërkues do të regjistrojë edhe arsyen për kërkimin apo ofrimin, si dhe një identifikues për zyrtarin që kryen kërkimin dhe zyrtarin që urdhëron kërkimin apo ofrimin.

3. Organi regjistrues do të komunikojë menjëherë të dhënat e regjistruara me kërkesë të autoriteteve kompetente të mbrojtjes së të dhënave të palës përkatëse, jo më vonë se katër javë pas marrjes së kërkesës. Të dhënat e regjistruara mund të përdoren vetëm për qëllimet e mëposhtme:

a) monitorimin e mbrojtjes së të dhënave;

b) garantimin e sigurisë së të dhënave.

4. Të dhënat e regjistruara do të mbrohen me masa të përshtatshme kundër përdorimit jo të duhur dhe formave të tjera të përdorimit të papërshtatshëm dhe do të ruhen për dy vjet. Pas periudhës së ruajtjes të dhënat e regjistruara do të fshihen menjëherë.

5. Përgjegjësia për kontrollet ligjore mbi ofrimin ose marrjen e të dhënave personale bie mbi autoritetet e pavarura të mbrojtjes së të dhënave ose, kur është e përshtatshme, mbi autoritetet gjyqësore të palëve përkatëse. Çdokush mund ti kërkojë këtyre autoriteteve të kontrollojnë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave në lidhje me personin e tyre, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Pavarësisht nga këto kërkesa, këto autoritete dhe organet përgjegjëse për regjistrimin do të kryejnë kontrolle rastësore mbi ligjshmërinë e ofrimit, në bazë të dosjeve të përfshira.

6. Rezultatet e kontrolleve të tilla do të mbahen për inspektim për 18 muaj nga autoritetet e pavarura për mbrojtjen e të dhënave. Pas kësaj periudhe ato do të fshihen menjëherë. Çdo autoriteti të mbrojtjes së të dhënave mund t'i kërkohet nga autoriteti i pavarur i mbrojtjes së të dhënave të një pale tjetër të ushtrojë kompetencat e saj në përputhje me legjislacionin kombëtar. Autoritetet e pavarura për mbrojtjen

e të dhënave të palëve do të kryejnë detyrat e inspektimit të nevojshme për bashkëpunimin e ndërsjellë, në veçanti duke shkëmbyer informacionin e duhur.

Neni 18

Të drejtat e subjektit të të dhënave dhe dëmtimet

1. Me kërkesë të subjektit të të dhënave në bazë të legjislacionit kombëtar, informacioni do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar të subjektit të të dhënave pas dhënies së vërtetimit të identitetit të tij, pa shpenzime të paarsyeshme, në terma të përgjithshme të kuptueshme dhe pa vonesa të papranueshme, mbi të dhënat e përpunuara në lidhje me personin e tij, origjinën e të dhënave, marrësin ose grupin e marrësve, qëllimin e synuar të përpunimit dhe kur kërkohet nga legjislacioni kombëtar, bazën ligjore për përpunimin.

Për më tepër, subjekti i të dhënave do të ketë të drejtë të t'i korrigjohen të dhënat e pasakta dhe t'i fshihen të dhënat e përpunuara në mënyrë të paligjshme. Palët gjithashtu do të sigurojnë që në rast të shkeljes së të drejtave të tij në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, subjekti i të dhënave do të jetë në gjendje të paraqesë një ankesë efektive te një gjykatë e pavarur ose një gjykatë sipas kuptimit të nenit 6 pika 1 të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut ose një autoritet i pavarur i mbrojtjes së të dhënave i ngritur nga legjislacioni kombëtar në përputhje me standardet esencialisht të barasvlershme me Direktivën (BE) 2016/680 dhe me Konventën përkatëse të Këshillit të Europës dhe rekomandimeve dhe që subjektit të të dhënave i jepet mundësia të pretendojë për dëmet, ose të kërkojë një formë tjetër dëmshpërblimi ligjor. Rregullat e hollësishme për procedurën që pohojnë këto të drejta dhe arsyet për kufizimin e të drejtës së aksesit do të rregullohen nga dispozitat përkatëse ligjore kombëtare të palës, ku subjekti i të dhënave kërkon të drejtat e tij.

2. Kur organi i një pale ka ofruar të dhëna personale sipas kësaj Marrëveshjeje, organi marrës i palës tjetër nuk mund të përdorë pasaktësinë e të dhënave të ofruara si bazë për të shmangur përgjegjësinë e saj ndaj palës së dëmtuar, në bazë të legjislacionit kombëtar. Nëse dëmet janë dhënë kundër organit pritës për shkak të përdorimit të tij të të dhënave të pasakta të transferuara, organi që ofron të dhënat duhet të dëmshpërblejë plotësisht organin pritës.

Neni 19

Informacion i kërkuar nga palët

Pala pritëse do të informojë palën ofruese mbi kërkesën e përpunimit të të dhënave të ofruara dhe rezultatet e arritura.

KAPITULLI V
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Marrëveshja Zbatuese dhe Manualet e Përdorimit

1. Në bazë dhe në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, palët do të lidhin një Marrëveshje për zbatimin e saj.

2. Manualet e Përdorimit do të përgatiten dhe do të mbahen të përditësuara nga grupet e ekspertëve të punës të përbërë nga përfaqësuesit e palëve. Manualet e Përdorimit përmbajnë informacion teknik dhe administrativ që nevojitet për shkëmbim efikas dhe efektiv të të dhënave.

Neni 21

Vlerësimi i shkëmbimit të të dhënave

1. Do të kryhet një vlerësim për aplikimin administrativ, teknik dhe financiar të shkëmbimit të të dhënave sipas kapitullit II të kësaj Marrëveshje. Vlerësimi duhet të kryhet përpara se të fillojë shkëmbimi i

të dhënave. Nëse nevojitet, vlerësimi mund të përsëritet për palët që zbatojnë tashmë këtë Marrëveshje. Vlerësimi do të kryhet sipas kategorive të të dhënave për të cilat shkëmbimi i të dhënave ka nisur midis palëve në fjalë. Vlerësimi do të jetë në bazë të raporteve të palëve përkatëse.

2. Vlerësimi do të kryhet nga një grup i përbashkët pune i përbërë nga përfaqësues të palëve. Grupi i punës do të mblidhet me kërkesë të një pale ose mbi baza të rregullta çdo 5 vjet.

Neni 22

Marrëdhënia me Marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë asnjë të drejtë, detyrim apo përgjegjësi të palëve që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat janë palë.

2. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe shprehimisht në këtë Marrëveshje, bashkëpunimi do të kryhet në përputhje me qëllimin e legjislacionit kombëtar përkatës të palëve.

Neni 23

Zbatimi dhe aplikimi

1. Palët do të informojnë Depozitarin që kanë zbatuar detyrimet e vendosura për ta sipas kësaj Marrëveshjeje dhe pikat kombëtare të kontaktit të caktuara sipas Marrëveshjes.

2. Pasi është kryer një vlerësim pozitiv i një pale në kontekstin e kësaj Marrëveshje (neni 21) ose i bërë nga Bashkimi Europian, pala respektive ka të drejtë të zbatojë këtë Marrëveshje menjëherë në lidhje me të gjitha palët e tjera, të cilat gjithashtu janë vlerësuar pozitivisht. Pala respektive do të informojë Depozitarin siç duhet.

3. Deklaratat e paraqitura në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mund të ndryshohen në çdo kohë.

Neni 24

Depozitari

1. Depozitari i kësaj Marrëveshjeje është Serbia.

2. Depozitari i dërgon një kopje të vërtetuar të kësaj Marrëveshjeje secilës palë.

3. Depozitari do të njoftojë palët për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të çdo deklarate apo njoftimi të kryer në lidhje me këtë Marrëveshje.

4. Depozitari do të njoftojë të gjitha palët për çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje në përputhje me nenin 26.

Neni 25

Ratifikimi, pranimi, miratimi, aderimi apo rezervat

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit të palëve. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen te Depozitari.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga çdo palë e PCC SEE-s. Instrumenti i aderimit do të depozitohet te Depozitari.

3. Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet kësaj marrëveshjeje.

Neni 26

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për secilën palë që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në

ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit nga kjo palë e instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

Neni 27

Tërheqja dhe pezullimi

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

2. Çdo palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë, me anë të një njoftimi me shkrim te Depozitari. Tërheqja do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari.

3. Pavarësisht mbarimit të kësaj Marrëveshje, dispozitat e formuluara në Kapitullin IV do të vazhdojnë të aplikohen në lidhje me të dhënat e përpunuara.

4. Çdo palë mund të pezullojë funksionimin e kësaj Marrëveshjeje tërësisht ose pjesërisht, nëse është e nevojshme për arsye të rendit publik, mbrojtjes së sigurisë kombëtare ose mbrojtjes së shëndetit publik. Palët do të njoftojnë Depozitarin pa vonesë për marrjen ose heqjen e një mase të tillë. Çdo masë e marrë sipas këtij paragrafi do të bëhet efektive 15 ditë pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari.

5. Depozitari duhet të informojë pa vonesë palët e tjera për njoftimin e tërheqjes apo pezullimin.

Bërë në Vjenë, më …… 2018, në një origjinal të vetëm në gjuhën angleze.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje:

Për Republikën e Shqipërisë

(……)

Për Republikën e Austrisë

(……)

Për Bosnje-Hercegovinën

(……)

Për Republikën e Bullgarisë

(……)

Për Hungarinë

(……)

Për Republikën e Maqedonisë

(……)

Për Republikën e Moldavisë

(……)

Për Malin e Zi

(……)

Për Rumaninë

(……)

Për Republikën e Serbisë

(……)

Për Republikën e Sllovenisë

MARRËVESHJE ZBATUESE

PËR MARRËVESHJEN NDËRMJET PALËVE TË KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE PËR SHKËMBIMIN E AUTOMATIZUAR TË TË DHËNAVE TË ADN-SË,DAKTILOSKOPIKE DHE TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE

Palët në këtë Marrëveshje Zbatuese,

Bazuar në Konventën e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (në vijim referuar si PCC SEE),

Në përputhje me nenin 20 të Marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor në Evropën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve (në vijim e referuar si: "Marrëveshja"),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i dispozitave të nevojshme administrative dhe teknike për zbatimin e marrëveshjes.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të përdoren përkufizimet në nenin 1 të Marrëveshjes.

Neni 3

Specifikimet teknike

1. Palët do të respektojnë specifikimet e përbashkëta teknike në lidhje me të gjitha kërkesat dhe përgjigjet që lidhen me kërkimet dhe krahasimet e profileve të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Për kërkimin dhe sigurimin e të dhënave të mëtejshme personale dhe informacioneve të tjera pas konfirmimit të përputhjes daktiloskopike ose të ADN-së nëpërmjet pikave kombëtare të kontaktit në përputhje me nenet 7 dhe 8 të Marrëveshjes, përcaktimi dhe struktura e të dhënave personale bazë, informacioni i rëndësishëm penal dhe/ose të dhëna të çështjeve penale mund të bihen dakord për thjeshtimin ose përshpejtimin e sigurimit të këtyre të dhënave të rëndësishme.

2. Këto specifikime teknike janë përcaktuar në Manualet e Përdorimit, siç referohen në nenin 20 të Marrëveshjes (në vijim të referuara si: "Manualet e Përdorimit").

Neni 4

Rrjeti i komunikimeve

1. Shkëmbimi elektronik i të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve ndërmjet palëve do të kryhet duke përdorur rrjete private të sigurta virtuale me kriptim.

2. Detajet teknike në rrjetin e komunikimit dhe detajet e kontaktit dhe disponueshmëria e pikave të

kontaktit teknik do të përcaktohen në Manualet e Përdorimit.

Neni 5

Disponueshmëria e shkëmbimit të të dhënave të automatizuara

Palët do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që kërkimi automatik ose krahasimi i të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve të jetë i mundur 24 orë në ditë dhe shtatë ditë në javë. Në rast të një defekti teknik, pikat kombëtare të kontaktit të palëve do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe do të bien dakord për një rregullim alternativ të përkohshëm të shkëmbimit të informacionit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Shkëmbimi automatik i të dhënave do të rivendoset sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 6

Parimet e shkëmbimit të të dhënave të ADN-së

1. Palët do të përdorin standardet ekzistuese për shkëmbimin e të dhënave të ADN-së, siç është Paketa e Standardeve Evropiane (ESS) ose Paketa e Standardeve e Loci (ISSOL) i Interpolit.

2. Procedura e transmetimit, në rastin e kërkimit të automatizuar dhe krahasimit të profileve të ADN-së, do të realizohet brenda një strukture të decentralizuar.

3. Do të merren masa të përshtatshme për të siguruar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave që u dërgohen palëve të tjera, duke përfshirë dhe kriptimin e tyre.

4. Palët do të marrin masat e nevojshme për të garantuar integritetin e profileve të ADN-së të vëna në dispozicion ose të dërguara për krahasim te palët e tjera dhe për të siguruar që këto masa janë në përputhje me standardet ndërkombëtare si ISO 17025.

5. Palët do të përdorin kodet e palëve në përputhje me standardin ISO 3166-1 alfa-2.

Neni 7

Rregullat për kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesa për një kërkim të automatizuar ose krahasim, siç referohet në nenet 3 dhe 4 të Marrëveshjes, duhet të përfshijë vetëm informacionin e mëposhtëm:

a) kodin e palës, të palës kërkuese;

b) datën, orën dhe numrin tregues të kërkesës;

c) profilet e ADN-së dhe numrat e tyre të referencës;

d) llojet e profileve të ADN-së të transmetuara (profilet e ADN-së së paidentifikuar ose profilet e ADN-së referuese); dhe

e) informacionin e kërkuar për kontrollin e sistemeve të bazës së të dhënave dhe kontrollin e cilësisë për proceset e kërkimit automatik.

2. Përgjigja (raporti i ngjashmërisë) me kërkesën e përmendur në paragrafin 1 do të përmbajë vetëm informacionin e mëposhtëm:

a) një tregues se a ka pasur një ose disa ngjashmëri (përputhje) ose nuk ka ngjashmëri (s'ka përputhje);

b) datën, kohën dhe numrin tregues të kërkesës;

c) datën, kohën dhe numrin tregues të përgjigjes;

d) Kodet e palëve, të palëve kërkuese dhe të kërkuara;

e) numrat e referencës të palëve kërkuese dhe të kërkuara;

f) lloji i profileve të ADN-së të transmetuara (profilet e ADN-së të paidentifikuar ose profilet e ADN-së referuese);

g) profilet e ADN-së të kërkuara dhe ngjashmëritë; dhe

h) informacionin e kërkuar për kontrollin e sistemeve të bazës së të dhënave dhe kontrollin e cilësisë

për proceset automatike të kërkimit.

3. Njoftimi i automatizuar i një ngjashmërie do të sigurohet vetëm nëse kërkimi automatik ose krahasimi ka rezultuar në një ngjashmëri të një numri minimal të loci (loci të ADN). Ky minimum është përcaktuar në Manualet e Përdorimit.

4. Palët do të sigurojnë që kërkesat të jenë në përputhje me deklaratat e lëshuara në pajtim me nenin 2 (3) të Marrëveshjes. Këto deklarata do të riprodhohen në Manualin e Përdorimit.

Neni 8

Procedura e transmetimit për kërkimin e automatizuar të profileve të ADN-së të paidentifikuara ose të referencës

1. Nëse, në një kërkim me një profil të ADN-së të paidentifikuar ose të referencës, nuk është gjetur asnjë ngjashmëri në bazën e të dhënave kombëtare ose është konstatuar një ngjashmëri me një profil të ADN-së, atëherë profili i ADN-së mund të transmetohet në të gjitha bazat e të dhënave të palëve të tjera, dhe nëse në një kërkim me këtë profil të ADN-së, janë konstatuar ngjashmëri me profilet e ADN-së referuese dhe/ose profilet e ADN-së të paidentifikuara në bazat e të dhënave të palëve të tjera, këto ngjashmëri do të komunikohen automatikisht dhe të dhënat e referencës së ADN-së do t'i transmetohen palës kërkuese; nëse nuk mund të konstatohet ngjashmëri në bazat e të dhënave të palëve të tjera, kjo do t'i komunikohet automatikisht palës kërkuese.

2. Nëse, në një kërkim me një profil të ADN-së të paidentifikuar, gjendet një ngjashmëri në bazat e të dhënave të palëve të tjera, secila palë e interesuar mund të përfshijë një shënim për këtë qëllim në bazën e tij kombëtare të të dhënave.

Neni 9

Parimet për shkëmbimin e të dhënave daktiloskopike

1. Digjitalizimi i të dhënave daktiloskopike dhe transmetimi i tyre në palët e tjera do të kryhet në përputhje me formatin uniform të të dhënave të përcaktuara në Manualet e Përdorimit.

2. Secila palë do të sigurojë që të dhënat daktiloskopike që ajo transmeton janë të cilësisë së mjaftueshme për një krahasim me sistemet e automatizuara të identifikimit të gjurmëve të gishtave (AFIS).

3. Procedura e transmetimit për shkëmbimin e të dhënave daktiloskopike do të kryhet brenda një strukture të decentralizuar.

4. Do të merren masat e duhura për të siguruar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave daktiloskopike që u dërgohen palëve të tjera, duke përfshirë dhe kriptimin e tyre.

5. Palët do të përdorin kodet e palëve në përputhje me standardin ISO 3166-1 alfa-2.

Neni 10

Kapacitetet kërkimore për të dhënat daktiloskopike

1. Secila palë do të sigurojë që kërkesat e saj të kërkimit nuk tejkalojnë kapacitetet e kërkimit të specifikuara nga pala e kërkuar. Palët do të dorëzojnë deklarata në të cilat përcaktojnë kapacitetet e tyre maksimale të kërkimit në ditë për të dhënat daktiloskopike të personave të identifikuar dhe për të dhënat daktiloskopike të personave që nuk janë identifikuar ende.

2. Numri maksimal i kandidatëve të pranuar për verifikim për transmetim përcaktohet në Manualet e Përdorimit.

Neni 11

Rregullat për kërkesat dhe përgjigjet në lidhje me të dhënat daktiloskopike

1. Pala e kërkuar do të kontrollojë cilësinë e të dhënave daktiloskopike të transmetuara pa vonesë me një procedurë plotësisht të automatizuar. Nëse të dhënat janë të papërshtatshme për një krahasim të automatizuar, pala e kërkuar do ta informojë pa vonesë palën kërkuese.

2. Pala e kërkuar do të kryejë kërkime sipas rendit në të cilin kërkesat janë marrë. Kërkesat do të përpunohen brenda 24 orëve me një procedurë plotësisht të automatizuar. Pala kërkuese, nëse legjislacioni i saj e parashikon, mund të kërkojë përpunimin e përshpejtuar të kërkesave të tij dhe pala e kërkuar do t'i kryejë këto kërkime pa vonesë. Nëse afatet nuk mund të përmbushen për arsye të forcës madhore, krahasimi do të kryhet pa vonesë sapo të jenë hequr pengesat.

Neni 12

Parimet e kërkimit automatik të të dhënave të regjistrimit të automjeteve

1. Për kërkimin e automatizuar të të dhënave të regjistrimit të automjeteve palët do të përdorin një version të aplikacionit të softuerit të Sistemit Evropian të Informacionit për Automjetin dhe Lejen e Drejtimit (EUCARIS) i projektuar posaçërisht për qëllimet e nenit 12 të vendimit të Këshillit 2008/615/JHA të 23 qershorit 2008, mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkufitar, dhe versioneve të ndryshuara të këtij programi.

2. Kërkimi i automatizuar i të dhënave të regjistrimit të automjeteve do të kryhet brenda një strukture të decentralizuar.

3. Informacioni i shkëmbyer nëpërmjet sistemit EUCARIS do të transmetohet në formë të kriptuar.

4. Elementet e të dhënave të të dhënave të regjistrimit të automjeteve që do të shkëmbehen përcaktohen në Manualet e Përdorimit.

5. Në zbatim të nenit 9 të Marrëveshjes, palët mund t'i japin përparësi kërkimit të lidhur me luftën kundër krimeve të rënda.

Neni 13

Kostot

Secila palë do të përballojë shpenzimet e veta që rrjedhin nga administrimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e kësaj Marrëveshjeje Zbatuese, veçanërisht nga aplikacioni softuerik EUCARIS i referuar në nenin 12.

Neni 14

Manualet e Përdorimit

Hollësi të mëtejshme në lidhje me informacionin administrativ dhe teknik të nevojshëm për shkëmbim efektiv të të dhënave përcaktohen në Manualet e Përdorimit.

Neni 15

Autoritetet e pavarura për mbrojtjen e të dhënave

Palët, do të informojnë Depozitarin e Marrëveshjes, mbi autoritetet e pavarura të mbrojtjes së të dhënave siç referohet në nenin 17 të Marrëveshjes.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje Zbatuese do të hyjë në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, në përputhje me nenin 26 të Marrëveshjes.

2. Kjo Marrëveshje Zbatuese lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Kjo Marrëveshje Zbatuese do të pushojë së ekzistuari në të njëjtën kohë me Marrëveshjen.

3. Kjo Marrëveshje Zbatuese mund të amendohet nga palët. Ky amendim do të dorëzohet me shkrim dhe do të hyjë në fuqi sipas procedurave të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për anëtarësim, në bazë të pranimit të mëparshëm në marrëveshje.

Bërë në Vjenë, më ..... 2018, në një origjinal të vetëm në gjuhën angleze.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Zbatuese:

Për Republikën e Shqipërisë
(……)
Për Republikën e Austrisë
(……)
Për Bosnje-Hercegovinën
(……)
Për Republikën e Bullgarisë
(……)
Për Hungarinë
(……)
Për Republikën e Maqedonisë
(……)
Për Republikën e Moldavisë
(……)
Për Malin e Zi
(……)
Për Rumaninë
(……)
Për Republikën e Serbisë
(……)
Për Republikën e Sllovenisë